



احترام مسلم

IHTIRAM I MUSLIM

(Albanian)



Shejhi i Tarikat Ameer-e-Ehli Sunnet
Themeluesi i Daveti Islami Al-lame Maulana Abu Bilal

MUHAMMAD ILYAS

Attar Qadiri Razavi

کاتب القرآن
القرآنی

احترامِ مُسْلِمِ

Ihtiram-i-Muslim

IHTIRAM-I MUSLIM

Kjo broshurë u shkrua në gjuhën urdu nga Shejhu i Tarikatit dhe themeluesi i Davet-i Islami, Hazreti Al-lama Muhamed Iljas Attar Kadiri Razavi دَامَتْ بَرَكَاتُهُمُ الْعَالِيَةِ. Kjo broshurë është përkthyer në shqip nga përkthyesi i departamentit të përkthimit (Davet-i Islami). Nëse konstatohet ndonjë gabim në përkthim, ju lutemi të kontaktoni përkthyesin e Mexhlisit (Dawat-i Islami) dhe do të shpërbleheni nga Zoti për të.

Translation Department (Dawat-e-Islami)

Aalami Madani Markaz, Faizan-e-Madinah, Mahallah Saudagran,
Purani Sabzi Mandi, Bab-ul-Madinah, Karachi, Pakistan

Phone: ☎ +92-21-111-25-26-92 – Ext. 7213

Email: ✉ translation@dawateislami.net

أَحْمَدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ وَالصَّلَاةِ وَالسَّلَامِ عَلَى خَاتَمِ النَّبِيِّينَ،
أَمَّا بَعْدُ فَأَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Lutja e leximit të librit

Përpara se të lexoni një libër ose mësim fetar, lexoni lutjen e mëposhtme! Në këtë rast, gjithçka që lexoni do të mbetet në mendjen tuaj لِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ. Lutja është si vijon:

اللَّهُمَّ افْتَحْ عَلَيْنَا حِكْمَتَكَ وَانْشُرْ
عَلَيْنَا رَحْمَتَكَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ

Përkthimi:

**O Allah عَزَّوَجَلَّ, na hap dyert e diturisë dhe urtësisë dhe na
lësho mëshirën Tënde! O i Madhërishëm dhe Falës!**

(Mustaraf vëll 1 fq.6.Darulfikir Beirut)

Shënim: Lexoni Salat-u Selam një herë në fillim dhe një herë në fund.

أَحْمَدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ وَالصَّلَاةِ وَالسَّلَامِ عَلَى خَاتَمِ النَّبِيِّينَ،
أَمَّا بَعْدُ فَأَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ ط

IHTIRAM-I MUSLIM *



Pavarësisht se sa shumë ju tundon shejtani me anë të dembelizmit, lexojeni këtë artikull në formë bisede që përbëhet prej 32 faqesh nga fillimi deri në fund. *إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ* Do të ndjeni një revolucion Madani (Medina) që po ndodh në zemrën tuaj.

Mirësia e Salatuselamit

Pronari i Medinës *صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ*, thotë: "Në mesin e njerëzve, ai që më përshëndet më shumë me selam do të jetë personi më i afërt me mua në Ditën e Gjykimit." (*Publikimi 27 Darul-Fikr, Bejrut; S Xhamia Tirmdhi, Hadithi Nr: 484 vëll 2*)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

* Ky fjalim i Emir-i-Ehli Sunneh *دَامَتْ بَرَكَاتُهُمُ الْعَالِيَةِ* Lëvizja Globale Jo-Politike Tabligh-e-Sunnah Davat-i-Islam' Në Konferencën Ndërkombëtare 3-ditore të Medinës, (11, 12, 13 Shabani Muadh-dham 1423 H Evlija Multan) dhe është përgatitur për ju si artikulli i parë me korrigjimet e nevojshme.

Paraja e rremë

Një zoroast çdo herë i linte një para të rremë Shejh Ebu Abdullah Hijatit si pagesë për qepjen që i bënte. Shejhu رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ e merrte gjithmonë. Një herë çiraku (ndihmësi) i hz. Shejhut nuk i pranoi paratë false të Zoroastrianit në mungesë të Shejhut رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ. Kur hz. Shejhu رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ kur u kthye, mësoi gjithçka që kishte ndodhur dhe i tha ndihmësit të tij: Pse nuk e more atë dirhem të rremë? Ai ka vite që më jep para të rremë dhe unë i marr në heshtje në mënyrë që ai të mos ia japë ndonjë myslimani tjetër. (*Ahya el Ulum, vëll. 03, fq. 77, Dar-ul-Kutub el Ilmija, Beyrut*)

Çfarë kërkon Daveti Islami (Dawat-i-Islami)

Të dashur vëllezër myslimanë! E patë! Paraardhësit tanë ishin aq të mbushur me shpirtin e Ihtirami Muslim (respekti ndaj myslimanëve) sa që merrnin përsipër dëmin për të mbrojtur myslimanët e panjohur nga dëmtimet e mundshme. Ndërsa, sot vëllai është i zënë edhe duke grabitur vëllain e vet. Lëvizja Globale Jo-Politike e Kuranit dhe Sunnetit, Dawat-i-Islami, dëshiron të mbajë gjallë epokën e paraardhësve tanë. “Dawat-i-Islami shkatërron urrejtjen dhe ofron kupa plot dashuri. Çdo vëlla mysliman duhet ta bëjë zakon të udhëtojë me autokolonën Medeni të dashamirëve të Resultit nga Medina për trajnimin e Sunnetit dhe të plotësojë fletoren korrigjuese çdo ditë dhe t’ia dorëzojë menaxherit të tij rajonal brenda dhjetë ditëve të para të çdo muaji Hixhri.

‘إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ’ (بُطْفَيْلٍ مُصْطَفَى) Shpirti i Ihtiram-i Muslim do të ringjallet. Në momenti që ndodh kështu ‘إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ’, shoqëria jonë do të kthehet sërish në një kopsht të bukur trëndafilash plot me lule shumëngjyreshe të këndshme, aromatike dhe gjithmonë të freskëta si Medina Munevvere. Përkthimi i poezisë,

Të gjitha vreshtat përveç Medinës do të shkatërrohen dhe do të zhduken,

O ju në vresht, këtë do ta shihni kur të vijë vjeshta

Tre persona të privuar (përgjithmonë) nga xhenneti.

Prindërit dhe të afërmit e tjerë (d.m.th., ata që kanë lidhje gjaku sipas shkallës së afërsisë) janë njerëzit që meritojnë respektin dhe trajtimin më të mirë në shoqëri, por për fat të keq atyre u kushtohet më së paku vëmendje. Edhe pse disa njerëz njihen si shumë të përvullur dhe të dashur në sytë e publikut, ata kanë temperament dhe moral jashtëzakonisht të keq në shtëpitë e tyre, veçanërisht ndaj prindërve. Në këtë mënyrë i bëjmë thirrje njerëzve të tillë, Transmetohet nga Hz. Abdullah Ibn Omer رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ se Pronari i botëve, Shëmbëlltyra e dritës, më i miri i bijve të Ademit صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ thotë: "Tre njerëz nuk do të hyjnë në xhennet, ata që sillen keq me prindërit, Dejjus (دَجِيْثٌ) (ata që nuk ndalojnë dhe as nuk e qortojnë gruan e tyre për shkak të imoralitetit që bën) dhe burrat që ngjasojnë me gratë.

(Mexhma el Zavaid, Hadithi Nr: 13431, vëll. 8, fq. 270, Dar-ul-Fikr, Beyrut)

Dejjuth (دَيُّوْث) Përkufizimi

Në hadithin e bekuar, thuhet se Dejjusi (دَيُّوْث) do të privohet nga xhenneti, si dhe ata që kryejnë dhunë ndaj prindërve të tyre. Dejjusi (دَيُّوْث) është një burrë aq i metë saqë nuk i intereson se me cilët burra jashtë familjes takohet gruaja e tij dhe gratë e tjera të familjes.

Duhet ta dini se Sheriati i ka bërë haram edhe djemtë e xhaxhallarëve, djemtë e dajave, djemtë e hallave, djemtë e tezeve, kunatat dhe kunetërit, bashkë me njerëzit e tjerë. Nëse një grua sillet lirisht dhe nuk e mban distancën e kërkuar nga Sheriati prej tyre, ajo do ta meritojë xhehennemin, dhe nëse një burrë nuk e pengon gruan e tij nga kryerja e këtij mëkati aq sa mundet, ai është prishës i Sheriatit dhe Dejjusi e meriton xhehennemin. Është e qartë se personi që është Dejjus është një mëkatar i mallkuar, të cilit nuk i pranohet për të qenë as imam e as dëshmitar.

Të dashur vëllezër myslimanë! Për trajnimin e Sunnetit, bëjeni zakon të udhëtoni me grupin Medeni të dashamirëve të Resultit dhe të plotësoni fletoren e veprave korrigjuese çdo ditë dhe t'ia dorëzoni menaxherit tuaj rajonal brenda dhjetë ditëve të para të çdo muaji Hixhri. 'إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ'. Ai gjithashtu do t'ju pastrojë nga sëmundja “dejjus”, e cila është një sëmundje jashtëzakonisht e paturpshme, dhe nga sëmundjet e tjera mëkatore, nëpërmjet të Dërguarit të Allahut ﷺ. Duke kërkuar ndërmjetësimin e syve të Tij të shenjtë u përkul me modesti, i

nderuari Hazreti Ala رَضِيَ اللهُ عَنْهُ. Ai paraqitet në praninë e Allahut, Përkthimi i poezisë,

O Zot, kur guximi im të lulëzojë

Qoftë me mua modestia e syve të Tij të modest

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Gruaja me veshje burrash e privuar nga xhenneti

Në hadith, gjithashtu thuhet, një grua që vishet me veshje burrash është gjithashtu e privuar nga xhenneti. Prandaj, në këtë grup përfshihet edhe një grua që vesh rroba burrash, vesh këpucë burrash ose qethet në stilin e burrit. Në ditët e sotme kjo çështje nuk merret në konsideratë për fëmijët, djali vishet si vajzë dhe duket si vajzë, vajza مَعَادَ اللهُ عَزَّوَجَلَّ është e veshur me rroba djemsh, si: pantallona, këmishë, këpucë, kapele për meshkuj, qethet si mashkull dhe duket si një mashkull. Nëse vepron kështu, ajo bëhet mëkatare. Myftiu hazreti Amcad Ali Azmi رَحِمَهُ اللهُ عَلَيْهِ shkruan: “Nëse doni të vendosni këna, aplikojeni atë vetëm në duart dhe këmbët e vajzës dhe mos i ngjyrosni duart dhe këmbët e djalit me këna, sepse edhe kjo është mëkat”.

(Rid el Muhtar, vëll.9, fq. 522, Dar-ul-Kutub el İlmiya, Beyrut)

Mos i vishni fëmijët tuaj me rroba me figura njerëzish ose kafshësh, mos i lyeni me manikyr si dhe nënat e tyre nuk

Ihtiram-i Muslim

duhet të përdorin manikyr, sepse e prish abdesin dhe guslin.

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Rrespekti ndaj vëllait të madh

Krahas prindërve duhet të ndihmohen edhe anëtarët e tjerë të familjes. Pas babait vjen gjyshi dhe vëllai i madh, sepse në vend të babait është vëllai i madh. Profeti Muhamed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, thotë: 'Një vëlla ka aq të drejta ndaj vëllait të tij sa babai ndaj fëmijës së tij.'

(Shub-ul-Iman, Hadithi Nr: 7929, vëll. 6, fq, 210, Dar-ul-Kutub el Ilmiya, Beyrut)

Mësojini fëmijët tuaj me moral

Prindërit gjithashtu duhet të respektojnë të drejtat e fëmijëve të tyre. Në vend që t'i bëni ato modern, bëjini ata shembull të gjallë të Sunneteve, korrigjoni moralin e tyre, mbajini larg mjedisit të keq, lidhini me mjedisin Medeni (Medine) (fetar) plot Sunnet, mbrojini nga filmat, teatri, këngë plot me zakone dhe tradita të këqija dhe evente të pamoralshme që i largojnë ata nga dashuria ndaj Allahut. Në ditët e sotme, prindërit ndoshta e perceptojnë si të drejtën e tyre t'u japin fëmijëve edukimin e kësaj bote, t'u mësojnë atyre një profesion dhe t'i ndihmojnë të fitojnë para. Fatkeqësisht, ata mendojnë të mbrojnë rrobat dhe trupin nga

papastërtia, por nuk mendojnë për pastërtinë e zemrave dhe aspiratave të fëmijëve të tyre. I dashuri i Allahut, **إِنَّ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ** Muhammedi **صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ** thotë se nëse një person u mëson respektin fëmijëve të tij, ai ka bërë një punë më të mirë se të japë 4 kg grurë si lëmoshë. (*Xhamia Tirmidhi, Hadithi Nr: 1958, vëll. 03, fq. 382*) Dhe ai gjithashtu thotë se një baba nuk mund t'u japë fëmijëve të tij asgjë më të mirë se morali i mirë. (*Shub-ul-Iman, Hadithi Nr: 1959, vëll. 3, fq. 383 Dar-ul-Kutub el İlmiya, Beyrut*)

Arsyeja pse nuk ka një mjedis fetar në shtëpi

Fatkeqësisht, sot shumica prej nesh nuk kemi një mjedis fetar në shtëpitë tona. Edhe ne kemi faj për këtë. Arsyet kryesore për këtë janë të folurit shumë pa kujdes, batutat, sjelljet e vrazhda, imoraliteti dhe indiferenca e skajshme brenda familjes sonë. Disa nga vëllezërit tanë mysliman sillen shumë modest në publik, por bërtasin si luanë në shtëpi. Kështu, respekti brenda familjes nuk vendoset kurrë dhe anëtarët e gjorë të familjes shpesh privohen nga integriteti në moralin e mirë. Kujdes! Nëse nuk përmirësoni moralin tuaj, nëse nuk trajtoni familjen tuaj me përlësi dhe mirësi dhe nuk punoni për t'i përmirësuar ato, kam frikë se mund të shkoni në xhehennem. Allahu i Madhëruar **عَزَّوَجَلَّ** thotë si vijon në kapitullin e 28-të, ajeti 6 i sures Tahrir:

**يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ
وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ**

Përkthimi i Kenz-ul-Iman

O ju që besuat! Mbroni veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.

Si ta mbrojmë familjen tonë nga xhehennemi

Sipas Hazainul Irfan حَزَائِنُ الْإِرْفَانِ "Me bindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, duke kryer adhurimin, duke i mësuar anëtarët e familjes për të mirën dhe ndalimin nga e keqja dhe duke u mësuar atyre diturinë dhe moralin (Mbroni veten dhe familjen tuaj nga zjarri i xhehennemit).

Respekti për të afërmit

Të gjithë të afërmit duhet të trajtohen mirë. Transmetohet nga hz. Sejidi ynë Asimi رَحِيحُ اللهِ عَنْهُ se i Dërguari i Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ ka thënë: "Kush dëshiron jetë të gjatë, dëshiron rehati në furnizim dhe dëshiron që vdekja e keqe të largohet prej tij, le të vazhdojë t'i frikësohet Allahut dhe të sillet mirë me të afërmit e tij." (*El Masnadarak Hadithi Nr: 7362, vëll. 5, fq. 222, Dar-ul-Kutub el Ilmiya, Beyrut*) Mustafa Xhani Rahmet, i dashuri i Zotit të Lartësuar صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, thotë: 'Ai që i prish lidhjet farefisnore nuk do të hyjë në xhennet.' (*Sahih Buhari, Hadithi Nr: 5984, vëll. 4, fq. 98, Dar-ul-Fikr, Beyrut*)

Këtu mungojnë disa rreshta

Pajtohuni me të afërmit e zemëruar

Të dashur vëllezër myslimanë, ata që zihen me të afërmit e tyre për gjërat më të vogla dhe i ndërpresin marrëdhëniet, le të marrin mësim nga këto hadithe të bekuara. Njerëz të tillë duhet të marrin drejtimin për të bërë paqe me të afërmit e tyre, edhe nëse të afërmit e tyre kanë faj, të takohen dhe të bëjnë paqe me ta me një fytyrë të qeshur. Të dashur vëllezër myslimanë! Për trajnimin e Sunnetit, bëjeni zakon të udhëtoni me grupin Medeni të dashamirëve të Resultit dhe të plotësoni fletoren e veprave korrigjuese çdo ditë dhe t'ia dorëzoni menaxherit tuaj rajonal brenda dhjetë ditëve të para të çdo muaji Hixhri. Me ndërmjetësim të hazreti Mustafasë **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ**, do të mbusheni me një entuziazëm të tillë, saqë jo vetëm që do të bëni paqe me të gjithë të afërmit tuaj, por ndoshta të gjithë ata do të përfshihen mjedisin i Dawat-i Islami pra në fe **إِنَّ شَاءَ اللهُ**. Përkthimi i poezisë,

*Të gjitha inatet e ëmbla
Do të përfundojnë, miku im
Le të ecim me kolonën
Ecni me Grupin Xhamia*

Virtyti i përkëdheljes së kokës së jetimit

Djali ose vajza që i ka vdekur babai quhet jetim. Kur një djalë

ose një vajzë arrin moshën madhore, ai ose ajo pushon së qeni jetim. Ka shpërblim të madh në trajtimin e mirë të jetimëve. Prandaj, Profeti Muhamed, صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, thotë: “Dora e atij që përkëdhel kokën e jetimit vetëm për hir të Allahut عَزَّوَجَلَّ, do të shpërblehet sa flokët që prek dhe kushdo që bën mirë, për një vajzë apo djalë jetim do të jetë me mua kështu (duke i bashkuar dy gishtat) në xhennet.” (*Mesned Imam Ahmed Hadithi Nr: 22215, vëll. 08, fq. 272, publikon Dar-ul-Fikr, Beyrut*)

Ngurtësia e zemrës zhduket duke përkëdhelur kokën e një jetimi dhe duke ushqyer të varfrit. Sipas sunnetit, kur e përkëdhelni kokën e jetimit, lëvizni dorën nga mbrapa përpara, dhe nëse jeni babai i fëmijës, lëvizni dorën drejt qafës së tij. (*El Mesnederak Hadithi Nr: 1279, vëll. 01, fq. 351, Dar-ul-Kutub el Ilmiya, Beyrut*)

Lindur nga brinja e shtrembër

Një burrë duhet ta trajtojë mirë gruan e tij dhe të jetë i mirë me të. Prandaj, Hz. Muhamedi صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ thotë: “Vërtet që gruaja ka lindur nga brinja e shtrembër. Ajo nuk drejtohet kurrë për ju. Nëse dëshironi të përfitoni prej saj, mund të përfitoni së bashku me shtrembërinë e saj, dhe nëse përpiqeni ta drejtoni atë, do ta thyeni, dhe thyerja e saj do të thotë ta divorconi atë.” (*Sahihi Muslim, vëll. 01 fq, 475 Afghanistan*)

Virtyti i të qenit i butë ndaj bashkëshortes tuaj

Si rezultat, mund të ndodhin disa gjëra jo të këndshme me bashkëshorten tuaj. Një burrë duhet të jetë i durueshëm. Profeti Muhamed ﷺ thotë: "Ata që kanë moral të mirë dhe janë të butë me gratë e tyre, janë ndër besimtarët e përsosur."

(Xhamia Tirmidhi Hadithi Nr: 2621 vëll. 04, S. 278 publikon, Dar-ul-Fikr, Beyrut)

Poshtërsi në ekstrem

Të dashur vëllezër myslimanë, në këtë hadith u bëhet thirrje të reflektojnë atyre që qortojnë dhe rrahin bashkëshortet e tyre për gjërat më të vogla. Të ngresh dorën kundër një femre dhe ta qortosh pa arsye, nuk është trimëri, përkundrazi, është jashtëzakonisht poshtërsi. Edhe nëse një grua gabon, duhet duruar sepse prej saj merren shumë dobi, ndaj duhet bwrw durim edhe me gabimet e saj. Profeti Muhamed ﷺ thotë: "Një besimtar nuk mund të ushqejë armiqësi ndaj një besimtareje. Edhe nëse ajo ka ndonjë ves të keq, patjetër që ndonjë ves tjetër e ka të mirë dhe të pranueshëm."

(Sahih Muslim, Hadithi Nr: 1463, 69, fq. 775)

Një rresht mangut

Të dashur vëllezër myslimanë, me bekimin e udhëtimit me kolonën Medeni të të dashuarve të Profetit dhe plotësimit dhe

Ihtiram-i Muslim

dorëzimit të librit të veprave korrigjuese çdo ditë, **إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ** (بِطُفْلِئِلِ مُصْطَفِيَّيْتِ) 'shtëpia juaj do të bëhet një shtëpi plot lumturi dhe 'إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ' familjes suaj do tu bëhet rrisht vizita e Medines Munevvere.

Përkthimi i poezisë,

O i zgjedhur, më zgjo rrishtun tim nga gjumi.

Më trego Medinën e ëmbël.

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Të drejtat e bashkëshortit

Edhe gruaja duhet të sillet mirë me burrin e saj. Prandaj, i dërguari i Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ ka thënë: Betohe në Allahun عَزَّوَجَلَّ në duart e të cilit është jeta ime. Nëse burri është mbushur me plagë nga këmbët në kokë dhe ka qelb që rrjedh në të gjithë trupin e tij, gruaja edhe nëse lëpin atë (qelbin) plotësisht, ajo nuk mund ta paguajë detyrimin e burrit të saj.' (*Mesnedi Imam Ahmed Hadithi Nr: 12614, vëll. 04, fq. 318 publikon Dar-ul-Fikr Beyrut*)

Gruaja të mos e braktisë shtëpinë e burrit edhe nëse ai është i dhunshëm

Gruaja e cila largohet nga shtëpia e burrit dhe shkon në

shtëpinë e babait të saj për arsyet më të vogla, duhet ta mësojë përmendësh këtë hadith dhe ta fusë thellë në zemrën e saj. Pejgamberi صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ thotë: "Dhe ajo (gruaja) nuk duhet të largohet nga shtëpia e tij (bashkëshortit) pa lejen e tij. Nëse ajo e bën këtë, Allahu عَزَّوَجَلَّ dhe engjëjt e Tij do ta mallkojnë atë nëse ajo nuk pendohet dhe kthehet. Kur u pyet nëse burri është një person i dhunshëm, Hazreti Pejgamberi صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ tha: "Edhe nëse ai është i dhunshëm". (*Kenzul Ammal Hadithi Nr: 44801, cëll. 16, fq. 144 Dar-ul-Kutub el Ilmiya Beyrut*),

Arsyeja pse shumica e grave janë të destinuara për në xhennem

Disa gra janë të pabindura dhe mosmirënjohëse ndaj burrave të tyre dhe kur dëgjojnë edhe fjalën më të vogël të keqe, i shpërfillin të gjitha veprat e mira që kanë bërë burrat e tyre në të kaluarën dhe fillojnë t'i qortojnë. Motrat tona myslimane, ato që shajnë burrat e tyre dhe bëjnë bujë, duhet të kenë frikë, sepse në një ditë Bajrami, duke kaluar pranë grave në rrugën e tyre për në namazin e Bajramit, Hazreti Pejgamberi صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ tha: 'O gra! Jepni lëmoshë sepse shumicën prej jush i kam parë si të destinuara për në xhennem. Kur e pyetën gratë: O i Dërguari i Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ! cila është arsyeja për këtë, ai tha: "Sepse i shani shumë burrat tuaj dhe jeni mosmirënjohëse tyre!" (*Sahihi Buhari Hadithi Nr: 304, vëll. 01, fq. 123 Dar-ul-Kutub el Ilmiya, Beyrut*)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Rëndësia e fqinjëve

Të dashur! Vëllezër mysliman: Të gjithë duhet t'i trajtojnë fqinjët e tyre mirë dhe t'i respektojnë ata pa ndonjë arsye që rrjedh nga ligji i Sheriatit. Dikush e ka pyetur Hazreti Pejgamberin **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ**, o i Dërguar i Allahut **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ**! Si do ta kuptoj nëse i bëj mirë apo keq fqinjit tim? Pejgamberi ynë **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ**, ka thënë: "Nëse i dëgjoni fqinjët tuaj të thonë se keni bërë mirë, sigurisht që keni bërë mirë, dhe nëse dëgjoni se keni bërë keq, me siguri keni bërë keq." (*Suneni Ibni Maxhe, Hadithi Nr: 4223, vëll. 04, fq. 479*)

Dëshmia e Karakterit të Lartë

رَبُّهُ أَكْبَرُ! Rëndësia e fqinjëve është aq e madhe sa që përmes tyre merret certifikata e karakterit të mirë. Më vjen keq që, pavarësisht kësaj, askush nuk i kushton vëmendje fqinjëve sot. Me bekimin e udhëtimit me kolonën Medeni të të dashuarve të Profetit dhe plotësimit dhe dorëzimit të broshurës së veprave korrigjuese çdo ditë, **إِنْ شَاءَ اللهُ عَزَّوَجَلَّ** (بَطْفَيْلِ مُصْطَفَى) rëndësia e fqinjëve do të ngrihet në zemrën tuaj dhe lagjja **إِنْ شَاءَ اللهُ عَزَّوَجَلَّ** juaj do të kthehet në një kopsht të Medinës.

Përkthimi i poezisë,

*O i Dërguari i Allahut le të vijë pranvera edhe në lagjen time!
Le të bjerë një re e mëshirës edhe në anët tona*

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Si duhet të jetë personi që do jetë udhëheqësi i grupit?

Gjatë udhëtimit, kreu i grupit duhet të jetë i respektueshëm ndaj shokëve të tij dhe t'u shërbejë atyre shumë. Sepse, në hadith ka thënë: “Vetëm ai që u shërben atyre në udhëtim është prijësi i tyre, shokët e tyre që dallohen në shërbim nuk mund t'i tejkalojnë me asnjë veprim të tyre, por nëse njëri prej tyre bie dëshmor, atëherë njëri prej tyre do të kalojë përpara.”¹

(Shub-ul-Iman, Hadithi Nr: 8407, vëll. 6, fq. 334, Dar-ul-Kutub el Ilmiya, Beyrut)

Dhënia e gjërave të tepërta për të tjerët

Gjatë një udhëtimi Hazreti Pejgamberi صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ tha: "Kush ka kafshë kalërimi tepër le t'ia dhurojë atij që nuk ka, e kush ka ushqim të tepërt le t'ia ofrojë atij që nuk ka ushqim" dhe të njëjtën gjë u tha edhe të tjerëve. Transmetohet nga Ebu Said Hudriu se Hz. Pejgamberi صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ 'foli për llojet e ndryshme të mallrave dhe ne kuptuam se nuk kemi të drejtë të mbajmë asgjë të tepërt përveç atyre që kemi nevojë.' *(Sahihi Muslim, vëll. 2, fq. 81, Afganistan)*

Ata në pozicione vartëse do të thirren në llogari

Të gjithë, jo vetëm drejtuesi i grupit, duhet t'i trajtojë mirë ata që janë në pozitat e tyre vartëse. I dashuri i Allahut

¹ Sunen Ibn Maxhe, Hadithi Nr: 42231, vëll. 4, fq. 479. Dar el Marifa, Beyrut.

Ihtiram-i Muslim

عَزَّوَجَلَّ Profeti Muhamed, صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ thotë: “Secili prej jush është përgjegjës dhe për ndonjë arsye udhëheqësi juaj është përgjegjës mbi të gjithë ju. "Ai do të përgjigjet për popullin e tij, dhe një burrë do të përgjigjet për shtëpinë e tij dhe do ti kërkohet llogari për shtëpinë e tij; dhe gruaja është përgjegjëse për shtëpinë e burrit të saj dhe ajo do të përgjigjet për familjen e saj." (Sahih Buhari, Hadithi Nr: 2409, vëll. 2, fq. 112, Dar-ul-Kutub el Ilmiya, Beyrut)

Të dashur vëllezër myslimanë, me bekimin e udhëtimit me kolonën Medeni të të dashuruarve të Profetit dhe me bereqetin e plotësimit dhe dorëzimit të librit të veprave korrigjuese ‘بَطْنِيْلِ مُصْطَفَى (إِنْ شَاءَ اللهُ عَزَّوَجَلَّ) Do të ketë respekt për ata që janë në pozita më të ulëta dhe ‘إِنْ شَاءَ اللهُ عَزَّوَجَلَّ’ të gjithë do të jenë të lumtur dhe do të lexojnë lutjen e Medinës për ju.

Përkthimi i poezisë,

*Unë nuk jam lypës i të mirave të kësaj bote
Për mua, vëllezërit e mi! Këndoni lutjen e Medinës*

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Ndarja e punës

Gjatë udhëtimit, puna duhet të ndahet në vend që t'i ngarkohet çdo detyrë vetëm një personi. Sahabet عَلَيْهِمُ الرِّضْوَانُ gjatë një udhëtimit kishin ndërmend të thernin një dhi dhe e ndanë

punën mes tyre; disa morën përsipër të therin dhinë, disa të rrjepin lëkurën dhe disa të gatuanin mishin. Profeti Muhamed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ tha se mbledhja e druve të zjarrit duhet të jetë puna ime. Sahabët عَلَيْهِمُ الرِّضْوَانُ i thanë o i dërguari i Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ ! Lëre ta bëjmë ne këtë punë, por Profeti ynë صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, tha: "Unë e di që do ta bëni këtë me kënaqësi, por nuk më pëlqen të jem i dalluar në mesin tuaj dhe kjo nuk i pëlqen as Allahut عَزَّوَجَلَّ." (*Ithaf el Sadet el Mutfin, vëll. 08, fq. 210 Dar-ul-Kutub el Ilmiya, Beirut*)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Jepini vendin tuaj njerëzve të tjerë

Në tren, autobus etj., nëse ka pak vende për t'u ulur në automjete të tilla, disa persona duhet të qëndrojnë ulur gjithmonë dhe disa nuk duhet të qëndrojnë gjatë gjithë udhëtimit të tyre ulur. Të gjithë duhet të ulen me radhë dhe të bëjnë përpjekje për të fituar shpërblime. Hazreti Abdullah Ibn Mesudi transmeton se gjatë betejës së Bedrit ka pasur një deve për çdo tre persona. Prandaj, Hazreti Ebu Lubabe, Hazreti Aliu رَضِيَ اللهُ عَنْهُ dhe Hazreti Profeti صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ e ndanë devenë mes vete. Kur erdhi radha e Profetit صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ për të ecur, të dy sahabët thanë: O i Dërguar i Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ ! Ju vazhdoni të hipni, ne do të ecim në vendin tuaj. Profeti Muhamed, صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, tha: "Ju nuk jeni më të fortë nga unë dhe unë nuk kam më pak nevojë për shpërblim se sa ju." (Kështu që edhe

Ihtiram-i Muslim

unë kam nevojë për vepra të mira, pse të mos eci!) (*Sherh el Sunnet, Hadithi Nr: 2680, vëll. 05, fq. 566, Dar-ul-Kutub el Ilmiya Beyrut*)

Udhëtoni me Grupin Medeni (Medinase).

Të dashur! Vëllezër mysliman, me bekimin e udhëtimit me kolonën Medeni të të dashuruarve të Profetit dhe me bereqetin e plotësimit dhe dorëzimit të librit të veprave korrigjuese 'بُطْفَيْلٍ مُصْطَفَى' (إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ) dëshira për të sakrifikuar vendet tuaja për të tjerët dhe me bekimin e kësaj do t'ju jepet mundësia 'إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ' e haxhit dhe vizita në Medine, për udhëtarët e Medinës gjatë këtij udhëtimit do të vizitohen Mina Sherif dhe Muzdelifeja Sherif Arafati Sherif, Mekka Mukerreme dhe ju do të keni lumturinë t'u jepni vendet tuaja njerëzve të tjerë me entuziazëm në Medinae Munevvere. Përkthimi i poezisë,

*O Zoti im! Më lër me një pushim në Medine të shkoj
Më lër të jem helika e pishtarit i dy botëve dhe të shkoj*

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Mos zini shumë vënd

Në vende shumë të mbushura me njerëz si takimet, njeriu nuk duhet të zërë shumë vend për rehatinë e tij dhe të shkaktojë mbingarkesë për të tjerët. Hazreti Sehl Ibni Maaz رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا

transmeton se ne, bashkë me Profetin Muhamed ﷺ, duke shkuar në xhihad, njerëzit ngushtuan shumë vendet (d.m.th., ata zinin shumë hapësirë) dhe bllokuan rrugën. Për këtë arsye, Pejgamberi ﷺ e udhëzoi dikë atje dhe e urdhëroi që të bënte këtë njoftim: "Vërtet, kushdo që ngushton vendin (zë vendin e tjetrit), nuk ka xhihad për të." (*Suneni Ebu Davut, Hadithi Nr: 2629, vëll. 02, fq. 388, Dar el Fikr, Beyrut*)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Është Sunnet që të lëshojmë vend duke lëvizur anash

Është Sunnet që ata që ishin ulur më parë të lëvizin nga vendet e tyre për të lënë vend për të ardhurit e rinj. Hazreti Vasile Ibnul Hattab رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ tregon se një person erdhi në praninë e Profetit ﷺ. Profeti ﷺ në atë kohë ishte në xhami. Profeti ﷺ u zhvendos për atë person. Ai person tha gjithashtu: 'O i Dërguar i Allahut ﷺ, pse u munduat kur ishte një vend kaq i madh! Ai ﷺ tha: "Kur një mysliman sheh një mysliman tjetër, ai duhet të lëvizë për të." (*Shub-ul-Iman Hadithi Nr: 8933, vëll. 6, fq. 468, Dar-ul-Kutub el Ilmiya, Beyrut*)

Me bekimin e udhëtimit me kolonën Medeni të të dashuarve të Profetit dhe të plotësisimit dhe dorëzimit të broshurës së veprave korrigjuese çdo ditë, (بُظْفَيْلٍ مُصْطَفَى) 'إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ' do të ketë pak vend por plot bereqet për t'u përdorur, gjithashtu

Ihtiram-i Muslim

duke lëshuar vend për të tjerët dhe duke i bërë ata të rehatshëm dhe duke bërë punë sipas Sunnetit dhe **إِنَّ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ** juve do t'ju jepet vendi më i madh në Xhenet el Beki.

Përkthimi i poezisë,

Po të më varrosnin në varrezat Baki

Edhe asketët e kësaj bote më kishin zili mua rebelin

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Të folurit fshehurazi nga të tjerët që u rrethojnë.

Hazreti Abdullah Ibn Mesudi **رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ** transmeton se Pejgamberi **صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ** ka thënë: “Kur jeni tre veta, dy vetë nuk duhet të flasin fshehurazi nga personi i tretë derisa të vijnë më shumë njerëz në kuvendin tuaj, sepse ai i tretë do të mërzhitet për këtë arsye.” (*Sahihi Buhari Hadithi Nr: 6290, vëll. 04, fq. 185 Dar-ul-Kutub el Ilmiya Beyrut*) (Ndoshta po flasin për diçka për mua ose nuk më kanë konsideruar të denjë të më përfshijnë në bisedën e tyre etj.)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Të kërcesh safet

Ata që vijnë më vonë nuk duhet të injorojnë ata që erdhën më herët dhe u ulën në rreshtat e parë për namazin e xhumasë. Në

fakt, Profeti Muhamed ﷺ, thotë: "Personi që hidhet mbi qafën e njerëzve ditën e xhuma, do të bëhet urë për ata që shkojnë në xhehennem në ditën e gjykimit." (*Xhamia Tirmidhi, Hadithi Nr: 513, vëll. 02, fq. 48, publikon Dar El Fikr, Beyrut*)

Hyrja mes dy personave

Nëse dy njerëz ulen së bashku paraprakisht, është qartësisht kundër moralit dhe Ihtiram-i Muslimit të futesh mes tyre pa lejen e tyre. Profeti Muhamed ﷺ thotë: "Nuk i lejohet njeriut të ndajë dy njerëz pa leje." (D.m.th., të ulet mes tyre). (*Suneni Ebu Davut, Hadithi Nr: 4845, vëll. 04, fq. 48, Dar El Fikr, Beyrut*)

Sipas transmetimit të Hazreti Huzejfes رضى الله عنه, personi që shkon dhe ulet në mes të një takimi pa leje është i mallkuar në sytë e Profeti Muhamed ﷺ. (*Chamia Tirmidhi, Hadithi Nr: 2762, vëll. 04, fq. 346, publikoi Dar El Fikr, Beyrut*)

Profeti Muhamed ﷺ tha se askush nuk duhet të heqë të tjerët nga vendi i tyre ku janë ulur dhe të ulet vetë, por ata që janë ulur duhet të hapin vend për ata që vijnë. (*Sahihi Muslim, Hadithi Nr: 2128-77, fq. 1198*)

I dashuri i Allahut, Profeti Muhamed ﷺ thotë se: nëse njeriu largohet nga vendi i tij dhe pastaj kthehet në vendin e tij, ai ka më shumë të drejta në atë vend. (*Sahihi Muslim, Hadithi Nr: 2131-79, fq. 1199*)

Të dashur vëllezër Myslimanë: Nëse njëri prej jush e lë vendin

e tij për shkak të nevojës, për shembull për të hyrë në banjo apo për të marrë abdes, dhe kthehet menjëherë pas plotësimit të nevojës, askush tjetër nuk duhet të ulet në vend të tij. Megjithatë, disa njerëz i lënë gjërat e tyre paraprakisht vetëm për të zënë një vend në rreshtin e parë, gjë që nuk lejohet. Nuk ka të keqe nëse, për shkak të nevojës, rezervohet një vend për personin që këndon tekbir ose dëgjon dhe korrigjon Kur'anin gjatë teravive.

Të dashur vëllezër myslimanë! Me bekimin e udhëtimit me kolonën Medeni të dashamirëve të Profetit dhe të plotësimit dhe dorëzimit të librit të veprave korrigjuese çdo ditë, 'إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ', duke u përmbajtur nga bërja e padrejtësive ndaj të tjerëve dhe thyerja e zemrave dhe respektimi i myslimanëve, duke vepruar kështu do të forcohet dhe me bekimet e kësaj rregullimi të Medinës (Medine), 'إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ' Ju do të keni mundësinë të udhëtoni për në haxhillëkun 'إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ' dhe të vizitoni Medinën, dhe do të keni mundësinë t'i ndiqni këto Sunnete edhe atje.

Përkthimi i poezisë,

*Lërinë të gjithë të dashuruarit tuaj të vijnë në Arabi
Le të shohin të gjithë Haremin dhe Mbretin e Haremit*

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Mos ia thyeni zemrën askujt

I dashur! Vëllazëria Myslimane Ihtiram-e-Muslim kërkon që të gjitha të drejtat e çdo myslimani të respektohen në të gjitha rastet dhe të mos thyhen zemra e asnjë myslimani pa lejen e Sheriatit. Profeti Muhamed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ nuk ia theu kurrë zemrën askujt, nuk kritikoi askënd, nuk u tall me askënd, nuk refuzoi askënd, nuk turpëroi askënd, përkundrazi, ai i përqafoi të gjithë.

Edhe pse nuk ia vlen të takohemi

Edhe atë me mëshirë e mbulon Zoti

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Jeta e Hazreti Pejgamberit صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

Ne për të çuar në vend Ihtiram-i Muslimin, marrim parasysh jetën e tij صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ dhe duhet të ndjekim rrugën e tij. (xhuzi 21, Sureja Ahzab, Ajeti Nr: 21) Allahu عَزَّوَجَلَّ urdhëron,

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ

Përkthimi i Kenz-ul-Iman Sigurisht që është më mirë për ju të ndiqni rrugën e të Dërguarit të Allahut.

52 Sunnete të mira

Të dashur vëllezër dhe motra! Sigurisht, Profeti Muhamed

Mustafa صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ është personi më i çmuar, madhështor dhe më i nderuar nga të gjitha qeniet dhe është obligim i madh të tregosh respekt ndaj Tij. Tani, unë do të shpalos para jush rreth 52 Sunnete të shenjta, të cilat janë udhërrëfyesi ynë për Ihtiram-i Muslim:

1. Profeti Muhamed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ gjithmonë ruante gjuhën e tij dhe fliste vetëm kur ishte e nevojshme,
2. Ai i donte të gjithë dhe kurrë nuk bënte asgjë të urryer.
3. Ai e respektonte njeriun e respektuar të popullit dhe e emëronte atë si udhëheqës të popullit të tij,
4. Ai u rrënjosi njerëzve frikën ndaj Allahut عَزَّوَجَلَّ.
5. Ai صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ mbrohej nga dhunimi i njerëzve, por dhembshuria dhe morali i tij nuk i pakësoheshin kurrë.
6. Ai صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ i pyeste shokët عَلَيْهِمُ الرِّضْوَان se si ishin a ishin mirë,
7. Ai i tregonte dhe i përkrahte veprat e mira të njerëzve, i quante të këqija të këqijat e tyre dhe i ndalonte nga shkuarja pas tyre.
8. Ai zgjidhte modestinë (mesataren) në gjithçka,
9. Ai nuk kishte asnjë llastim,

10. Ai kurrë nuk ishte i pavëmendshëm ndaj reformimit të njerëzve.
11. Ulja dhe qëndrimi i tij صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ në këmbë ishin gjithmonë me përmendjen e Allahut عَزَّوَجَلَّ.
12. Kur shkonte diku, ulej kudo që e gjente vend të lirë dhe të njëjtat sugjerime u jepte të tjerëve.
13. Ai respektonte të drejtat e atyre që ishin ulur pranë tij.
14. Ai صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ bënte që të gjithë të pranishmit në praninë e tij të ndjeheshin sikur i donte më shumë se kushdo tjetër.
15. Ai nuk ikte dhe ta linte vetëm dikë që vinte tek ai dhe bisedonte me të, para se të ngrihej dhe të largohej ai që kishte ardhur pranë tij.
16. Ai nuk e hiqte dorën i pari kur shtrëngonte dorën me dikë,
17. Ai i ndihmonte ata që i kërkonin ndihmë,
18. Bujaria dhe humori i tij صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ i mirë ishin të hapura për të gjithë,
19. Takimet dhe bisedat e tij صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ përbëheshin nga dituria, modestia, durimi dhe besimi.
20. Nuk kishte zhurmë në kuvendin e Tij صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, as nuk turpërohej kush.

21. Kur dikush bënte një gabim në kuvendin e tij **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ**, ai nuk qortohej dhe as nuk talleshin me të.
22. Kur i kushtonte vëmendje dikujt, i kushtonte vëmendje të plotë,
23. Sytë e tij qëndronin të ulur nga modestia,
24. Ai **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ** ishte më i turpshëm se një vajzë e virgjër,
25. Kur përshëndeste me selam, ai ishte i pari që jepte selam,
26. Ai i përshëndeste me selam edhe fëmijët,
27. Ai me një person me të cilin bisedonte nuk do t'i kthente fytyrën përpara se ai të largohej prej andej.
28. Ai nuk do t'i shtrinte këmbët e tij ndaj atyre që ishin ulur në tubimin e tij,
29. Shumicën e kohës ai ulej përballë Kiblës.
30. Kur ofendohej nga fjalët e dikujt, thoshte: Allahu **عَزَّوَجَلَّ** i dhëntë mirësi.
31. Ai nuk do të hakmerrej ndaj askujt për gjëra të tij personale,
32. Ai e falte të keqen në vend që të përgjigjej me të keqe,
33. Ai nuk goditi askënd me dorën e tij, përveç Xhihadit në rrugën e Allahut **عَزَّوَجَلَّ**, as ndaj skllavit dhe as ndaj gruas,
34. Ai ishte i butë në fjalën e tij, ai thotë: "Në Ditën e Gjykimit, personi më i keq në sytë e Allahut **عَزَّوَجَلَّ** do të

jetë ai që të gjithë e braktisën për shkak të fjalës së tij të keqe. (*Sahihi Muslim, vëll. 02, fq. 322 Afganistan*)

35. Paraqitja e tij ishte e butë dhe gjithmonë në formë,
36. Nuk bërtiste asnjëherë,
37. Nuk fliste me zë të ashpër asnjëherë,
38. Ai nuk do të turpëronte askënd,
39. Ai nuk do të ishte dorështrënguar,
40. Veçanërisht e mbronte veten nga tre gjëra: lufta, mendjemadhësia dhe përfshirja në gjëra të panevojshme.
41. Ai nuk do të kërkonte të metat e askujt,
42. Ai kurrë nuk qortonte askënd për gjërat e tij personale,
43. Ai fliste dhe bënte vetëm gjëra që do të çonin në vepra të mira.
44. Ai ishte i durueshëm me të folurën e ashpër të mikut dhe pyetjet e papërshtatshme të tij,
45. Ai as nuk e ndërpriste askënd në bisedë dhe as nuk hynte në mes të bisedës.
46. Kur dikush fliste marrëzira, ai e ndalonte ose ngrihej që andej,
47. Thjeshtësia e tij nuk i kursente një vend të veçantë për t'u ulur, që do ta dallonte nga të tjerët. (*Ihja el Ulum, vëll. 02, fq. 396*)

48. Herë shtrihej në qilim dhe herë shtrihej në tokë dhe pushonte.
49. Ai përdorte krahun e tij si jastëk kur flinte,
50. Ai صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ fliste aq i qartë sa çdokush mund t'i numëronte fjalët e tij.
51. Ai kurrë nuk qeshte (me zë të lartë sa ta dëgjojnë të tjerët),
52. Gjatë bisedës, ai nuk e shikonte fytyrën e bashkëbiseduesit, pra nuk i ngulte sytë.

Pasi ta lexoni këtë libër, jepjani dikujt tjetër

Bëni vepra të mira duke shpërndarë këto fletushka të vlefshme për thesarin e shtypur nga 'Mektebetul Medina' kur mbliidheni në ceremoni të lumtura si dasma ose ditëlindje, ose në ditë të dhimbshme. Bëjeni zakon t'i mbani në dyqanin tuaj për t'i bërë dhurata klientëve tuaj. Ftojini ata në vepra të mira duke i shpërndarë nëpër shtëpi të paktën një herë në muaj përmes, shpërndarësve të gazetave ose fëmijëve dhe merrni pjesën tuaj nga kjo vepër e mirë.

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Përmbajtja

IHTIRAM-I MUSLIM	1
Mirësi e Salatuselamit	1
Paraja e rremë	2
Davet-i Islami (Dawat-e-Islami)	2
Tre persona të privuar (përgjithmonë) nga xhenneti.	3
Dejjuth (دَيْوُث) Përkufizimi.....	4
Gruaja me veshje burrash e privuar nga xhenneti	5
Rrespekti ndaj vëllait të madh	6
Mësojini fëmijët tuaj me moral	6
Arsyeja pse nuk ka një mjedis fetar në shtëpi.....	7
Përkthimi i Kenz-ul-Iman.....	8
Si ta mbrojmë familjen tonë nga xhehennemi	8
Respekti për të afërmit.....	8
Këtu mungojnë disa rreshta.....	9
Pajtohuni me të afërmit e zemëruar	9
Virtyti i përkëdheljes së kokës së jetimit	9
Lindur nga brinjët e shtrembër	10
Virtyti i të qenit i butë ndaj bashkëshortes tuaj	11
Poshtërsi në ekstrem	11
Një rresht mangut	11
Të drejtat e bashkëshortit.....	12

Gruaja të mos e braktisë shtëpinë e burrit edhe nëse ai është i dhunshëm.....	12
Arsyeja pse shumica e grave janë për në xhehennem.....	13
Rëndësia e fqinjëve.....	14
Dëshmia e Karakterit të Lartë.....	14
Si duhet të jetë personi që do jetë udhëheqësi i grupit?.....	15
Dhënia e gjërave të tepërta për të tjerët.....	15
Ata në pozicione vartëse do të thirren në llogari.....	15
Ndarja e punës.....	16
Jepini vendin tuaj njerëzve të tjerë.....	17
Udhëtoni me Grupin Medeni (Medinase).....	18
Mos zini shumë vënd.....	18
Është Sunnet që të lëshojmë vend duke lëvizur anash.....	19
Të folurit fshehurazi nga të tjerët që u rrethojnë.....	20
Të kërcesh safet.....	20
Hyrja mes dy personave.....	21
Mos ia thyeni zemrën askujt.....	23
Jeta e Hazreti Pejgamberit ﷺ.....	23
Përkthimi i Kenz-ul-Iman Sigurisht që është më mirë për ju të ndiqni rrugën e të Dërguarit të Allahut.....	23
52 Sunnete të mira.....	23

Pasi të keni lexuar këtë broshurë, sigurisht që dëshironi të njihni autorin e saj. Kjo broshurë është shkruar nga Hazreti 'Al-lameh Maulana Muhamed Ilyas Attar Kadiri Razavi *داعية بَرَكَاتِهِمُ الْعَالِيَةِ*, një nga të mëdhenjtë e shekullit të 21-të me personalitetin e tij shpirtëror. Është shkruar në gjuhën urdu. Ky njeri i nderuar është themeluesi i lëvizjes mbarëbotërore jopolitike 'Dawat-e-Islami' të Kuranit dhe Sunnetit. Kjo organizatë studion afërsisht 93 tema nga Kurani dhe Sunneti dhe ia shpërndan këtë informacion njerëzimit. Nëse dëshironi të dini për këtë njeri të nderuar apo librat e tij apo materialet e ndryshme të “Dawat-e-Islami”, mund të na vizitoni në këtë faqe interneti www.dawateislami.net. Përveç kësaj, 'Madani Channel', një kanal 100% islamik, shpërndan informacion islamik në mbarë botën. Kudo që të jeni në botë, nëse dëshironi të shikoni 'Madani Channel', ndiqni udhëzimet e frekuencës suaj rajonale më poshtë ose na dërgoni e-mail në overseas@dawateislami.net.

Ihtiram-i Muslim

Grafiku i përditësuar i frekuencave të kanalit Madani

Modulimi: QPSK

Sateliti	Gama	frekuenca e lidhjes	norma e simboleve	Polarizimi	FEC
AsiaSat 3S	Rajoni i Azisë	3739 MHz	2815 Msps	vertikale	3/4
Astra 2F	Rajoni i Anglisë	12840 MHz	22000 Msps	vertikale	5/6
Intelsat 20	Rajoni i Afrikës	12562 MHz	26657 Msps	horizontale	2/3
Eutelsat 7 West A	Rajoni i Lindjes së Mesme	10815 MHz	27500 Msps	horizontale	5/6

Reward of looking at Muslim with affection

The Beloved Prophet ﷺ has said: The Muslim who shakes hands with his brother whilst they have no hatred in their heart for each other, Allah ﷻ will forgive their past sins before their hands are separated, and whoever looks at his Muslim brother with affection and does not have hatred for him in his heart, then the past sins of both of them will be forgiven before he looks away.

(Kanz-ul-'Ummal, vol. 9, pp. 57, Hadees 25358)



Aalami Madani Markaz, Faizan-e-Madinah, Mahallah Saudagaran
Purani Sabzi Mandi, Bab-ul-Madinah, Karachi, Pakistan.

UAN: +92 21 111 25 26 92 | Ext: 1262

Web: www.dawateislami.net | E-mail: translation@dawateislami.net